



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 68

6 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 350, datë 20.3.2013	Për autorizimin e shoqërisë “Brecycle” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës për qëllime riciklimi	3011
Vendim i GJK nr. 17, datë 23.4.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.....	3012
Vendim i GJK nr. 18, datë 23.4.2013	Me objekt shfuqizimim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	3017
Vendim i GJK nr. 19, datë 25.4.2013	Me objekt: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 10 095, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimit nr. 760, datë 6.4.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2012-513, datë 8.3.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). 2. Pezullimi i vendimit deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.....	3022

VENDIM
Nr. 350, datë 20.3.2013

**PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “BRECYLE” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE
TË PLASTIKËS PËR QËLLIME RICIKLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 3 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të nenit 49 pika 2 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Brecycle” sh.p.k., për importin e mbetjeve të plastikës, me këto kode tarifore:

- | | |
|---------------------|---|
| - GH 010 3915 | - mbetje, prerjet dhe kthimet prej plastike; |
| - GH 011 ex 3915 10 | - prej polimereve të etilenit; |
| - GH 012 ex 3915 20 | - prej polimereve të stirenit; |
| - GH 013 ex 3915 30 | - prej polimereve të vinil kloridit; |
| - GH 014 ex 3915 90 | - prej plastikave të tjera (polimere ose bashkime polimeresh) |

dhe B3–B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve të plastikës që do të importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit. Mbetjet do të importohen nga Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe vendet e Bashkimit Europian. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim” dhe anekseve III dhe IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

3. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “Brecycle” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërav, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III e IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “Brecycle” sh.p.k., është njëvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “Brecycle” sh.p.k., edhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore, për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.



7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 17, datë 23.4.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtar	e	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Admir Thanza	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 22.11.2012, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 44/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Tom Dedaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. Prokuroria e Përgjithshme

2. Zyra e përmbarimit gjyqësor “Etebest”, Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha; mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Tom Dedaj, si dhe parashtrimet e paraqitura nga subjektet e interesuara, Prokuroria e Përgjithshme dhe zyra e përmbarimit gjyqësor “Etebest”, Tiranë, dhe, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi, Tom Dedaj, ka punuar si prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që nga data 20.11.2000, deri në datën 2.9.2009. Me dekretin nr. 6227, datë 2.9.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ai është larguar nga kjo detyrë.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me padi me objekt: “Shpalljen e kundërligjshëm të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 6227, datë 2.9.2009, për shkarkimin nga detyra e prokurorit”. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 8, datë 19.1.2010, ka vendosur që të rrëzojë padinë.

3. Mbi rekursin e bërë nga kërkuesi, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 495, datë 3.11.2011, ka vendosur që të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke shfuqizuar dekretin e sipërcituar për shkarkimin e kërkuesit. Gjithashtu, ka urdhëruar kthimin e kërkuesit në detyrën që ai ka pasur si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Deri në datën e kthimit në atë detyrë, kërkuesi duhej të paguhej me pagën që ka pasur që nga data e largimit, 22.5.2009.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 16.12.2011, ka lëshuar urdhrin nr. 117, për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar. Kërkuesi u është drejtuar disa herë institucioneve të Presidentit, Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Prokurorit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me qëllim ekzekutimin e tij

5. Kërkuesi, në datën 9.1.2012, i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit “Etebest”, Tiranë, për fillimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit. Në datën 24.1.2012, nga Zyra e Përmbarrimit, është bërë lajmërimi i Prokurorisë së Përgjithshme për ekzekutim vullnetar, i cili nuk është kryer.

5.1. Në datën 3.2.2012, Zyra e Përmbarrimit “Etebest” ka vendosur që të kalojë në ekzekutim të detyrueshëm, duke filluar me urdhër sekuestrimi të llogarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, në degën e thesarit, Tiranë.

5.2. Në datën 3.2.2012, nga Zyra e Përmbarrimit është urdhëruar dega e thesarit Tiranë, që të vendosë sekuestro ekzekutive në llogarinë e palës debitore, Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, në shumën në total 3 100 253 lekë.

5.3. Në datën 14.2.2012, me shkresën nr. 423/ex., Prokuroria e Përgjithshme ka vënë në dijeni Zyrën e Përmbarrimit “Etebest” se, për arsye të mungesës së fondeve dhe të mungesës së vendeve të lira në organikë, nuk e ka të mundur të ekzekutojë vendimin gjyqësor.

6. Në datën 16.2.2012, me shkresën nr. 423/9 prot., Prokuroria e Përgjithshme ka vënë në dijeni institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për pamundësinë objektive për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i ndryshuar nga vendimi i Gjykatës së Lartë, për rikthimin në punë dhe pagimin e pagave. Sipas kësaj shkrese, rezulton se: “Organika për prokurorë është e plotësuar, duke përfshirë këtu dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin”. Po ashtu, dhe për pagimin e detyrimit në të holla, sipas buxhetit të vitit 2012 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, nuk është akorduar ndonjë fond për shpërblimin e punonjësve, të cilët kanë fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë të drejtën për t’u shpërblyer. Për këtë qëllim, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i ka kërkuar Ministrisë së Financave që të çelë fondet e nevojshme për zgjidhjen përfundimtare të shpërbllimit të tyre.

7. Në datën 23.4.2012, Zyra e Përmbarrimit vendos të gjobisë palën debitore, Prokuroren e Përgjithshme, si titullare e Prokurorisë së Përgjithshme, për mosveprimin dhe mosnjoftimin e përmbarruesit gjyqësor brenda afatit, duke u konsideruar nga Zyra e Përmbarrimit si penguese në ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 8, datë 19.1.2010.

8. Pas gjithë këtyre veprimeve të kryera nga Zyra e Përmbarrimit, vendimi gjyqësor i formës së prerë ende është i paekzekutuar në tërësi të tij, si për rikthimin në detyrë të kërkuesit ashtu edhe për pagesën e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

II

9. **Kërkuesi** pretendon se gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 495, datë 3.11.2011, i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi për shkak të refuzimit dhe pasivitetit të organeve kompetente, vendimi i formës së prerë, dhënë në favor të tij, nuk po ekzekutohet edhe pse ka kaluar një vit nga dhënia e tij.

10. **Subjekti i interesuar**, në argumentet e paraqitura me shkrim, në mënyrë të përmbledhur ka ngritur këto prapësime:

10.1. Prokuroria e Përgjithshme ka bërë dhe po bën të gjitha përpjekjet e mundshme për ekzekutimin e vendimit.



10.2. Në zbatim të vendimit të gjykatës për kërkuesin dhe për persona të tjerë, që kanë fituar gjyqet për rikthimin në detyrën e prokurorit, Prokurori i Përgjithshëm, në mbështetje të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.2.2012, ka nxjerrë urdhrin nr. 54, datë 23.3.2012, në të cilin, ndër të tjera, thuhet: *“Prokuroria e Përgjithshme në buxhetin e vitit 2012 nuk ka fonde të mjaftueshme për shlyerjen tërësore të detyrimeve dhe njëkohësisht nuk ka vende të lira në strukturën e përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë...”*. Ky urdhër ka parashikuar dhe ekzekutimin e pjesëshëm të vendimit, duke u urdhëruar pagimi i shumës prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, sipas grafikut bashkëngjitur këtij urdhri. Ndërsa, pjesa e mbetur do të likuidohet tërësisht në vitin 2013.

10.3. Po në datën 23.3.2012, Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 423/16, i është drejtuar Ministrisë së Financave, duke parashtruar nevojshmërinë për mbështetje, e cila është kërkuar si në aspektin financiar, ashtu dhe në shtimin e numrit të punonjësve të sistemit të prokurorisë, pasi gjendeshin në pamundësi objektive për ekzekutimin e menjëhershëm të 7 vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin në punë të prokurorëve të shkarkuar, ndër të tjerë dhe të kërkuesit Tom Dedaj, si dhe pagimin e pagave të tyre.

10.4. Organika për prokurorë, në shkallë vendi, është e plotësuar. Gjithashtu, dhe organika e prokurorisë së rrethit gjyqësor Kurbin, është e plotësuar. Dy vendet vakante të mbetura pas shkarkimit nga detyra të kërkuesit dhe të një prokurori tjetër, janë plotësuar duke u caktuar dy prokurorë të tjerë. Ky plotësim ka qenë i kushtëzuar nga ngarkesa e punës së krijuar në atë periudhë kohore.

10.5. Prokuroria e Përgjithshme pretendon se, meqenëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë vazhdojnë dy gjykime lidhur me ekzekutimin e vendimit dalë në favor të kërkuesit, atëherë nuk janë ezauruar shkallët e tjera të gjykimit për të njëjtin objekt të paraqitur para kësaj gjykate.

III

Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

11. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, për arsye të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8, datë 19.1.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkuesit, që prej marrjes së këtij vendimi, i cili është i detyrueshëm, ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustificuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

12. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 15.04.2011; nr.14, datë 15.04.2010; nr.8, datë.23.03.2010; nr.9, datë 01.04.2009; nr.1, datë 19.01.2009*).

15. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

16. Gjykata vlerëson se është i pabazuar prapësimi i subjektit të interesuar, sipas të cilit ende nuk janë ezauruar shkallët e tjera të gjykimit për të njëjtin objekt. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451/ç të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e tij dhe pranimin e padisë së paraqitur nga kërkuari, duke urdhëruar kthimin e kërkuarit në detyrën e mëparshme të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, si dhe dhënien e pagës që nga data 22.5.2009, deri në kthimin e tij në detyrë .

17. Në çështjen konkrete, nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë, apo në fazën e veprimeve përmbarimore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky vendim është i ekzekutueshëm që nga data 3.11.2011, kur është marrë ky vendim. Gjykata konstaton se, deri në momentin e vendimmarrjes së saj, vendimi i formës së prerë ende nuk është ekzekutuar plotësisht.

ii) Kompleksiteti i çështjes

18. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve, duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

iii) Sjellja e kërkuarit

19. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuarit për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 22.5.2009 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte mungesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji me këtë qëllim.

20. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuari nuk ka kryer ndonjë veprim që mund të ketë sjellë vonesa në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Mbështetur në aktet e paraqitura nga palët, rezulton se kërkuari që në datën 16.12.2011 ka kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit nr. 495, datë 3.11.2011, duke i kërkuar subjektit të interesuar ekzekutimin e këtij vendimi. Kërkuari ka vënë në ekzekutim urdhrin e ekzekutimit, pasi është lëshuar nga Gjykata e Apelit



Tiranë. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi për ekzekutimin e vendimit i është drejtuar në mënyrë të përsëritur disa institucioneve si Zyrës së Përmbartimit Privat Tiranë, Presidentit të Republikës, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkuesit nuk ka shkaktuar vonesa në ekzekutimin e vendimit dhe se ai (kërkuesi) ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e të drejtës së cenuar.

iv) Sjellja e autoriteteve publike

22. Mbështetur në parashtrimet e palëve gjatë gjykimit dhe aktet paraqitur prej tyre, rezultojnë se subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, pretendon se mund të ekzekutojë gjatë vitit 2012 vetëm një pjesë të detyrimit financiar që i ngarkohet nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, ndërsa gjatë vitit 2013, merr përsipër ta ekzekutojë atë plotësisht dhe vijon të mbetet në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuesin në punë.

23. Subjekti i interesuar paraqiti në gjykim urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 54, datë 23.3.2012. Sipas këtij urdhri, subjekti i interesuar është angazhuar të shlyejë tërësinë e detyrimit financiar ndaj kërkuesit, pjesërisht brenda vitit 2012 dhe përfundimisht brenda vitit 2013. Në këto kushte, Gjykata, pavarësisht se, në thelb, mungesën e fondeve nuk e gjen si argument bindës për mosekzekutimin e vendimit, në tërësi vlerëson se subjekti i interesuar po tregon vullnet për të ekzekutuar detyrimet financiare që burojnë nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

24. Megjithatë, Gjykata vëren që subjekti i interesuar vijon t'i përmbahet qëndrimit, sipas të cilit ai është në pamundësi për të rikthyer kërkuesin në punë për shkak se organika e prokurorisë, siç është përcaktuar me ligj, është e plotësuar dhe nuk ka vende të lira. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Mbështetur në aktet e paraqitura nga palët gjatë gjykimit, rezultojnë se me propozim të subjektit të interesuar janë emëruar me dekret të Presidentit të Republikës disa prokurorë, që më parë ushtronin funksionin e oficerit të policisë gjyqësore ose të Drejtorit të Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme. Më konkretisht, rezultojnë se me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7504, datë 4.6.2012, janë emëruar 10 prokurorë pranë prokurorive të rretheve të ndryshme gjyqësore. Provohet se asnjë nga këto pozicione nuk i është ofruar kërkuesit.

26. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se subjekti i interesuar ka pasur mundësi për të ekzekutuar detyrimin ndaj kërkuesit duke e rikthyer atë në detyrë, qoftë pranë një prokurorie të një rrethit tjetër. Subjekti i interesuar jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por nuk ka shfaqur deri tani vullnet për të bërë një veprim të tillë, pasi vazhdon të shprehë hapur se ndodhet në pamundësi për të ekzekutuar këtë detyrim.

27. Si përfundim, Gjykata çmon se subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet sjelljes së tij, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për shkak të mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në pjesën që parashikon rikthimin në detyrë të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 8, datë 19.1.2010, sa i përket detyrimit për të rikthyer në detyrë kërkuesin.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

VENDIM
Nr. 18, datë 23.4.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtar e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtar e	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 17.1.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 51/24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a.;

Shoqëria “Rubin Petrol Patos” sh.a.,

të përfaqësuar nga avokate Irena Reso, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Saimir Vrioni, i përfaqësuar nga avokati Bashkim Asllani, me deklaram në seancë plenare.

Altin Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni, Arshi Vrioni, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 41/1, 42, 131/f dhe 132/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesen e kërkuesve, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Saimir Vrioni, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

1. Me vendimin nr.2, datë 19.12.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve (KKKP), pranë Këshillit të Rrethit Fier, ndër të tjera, ka vendosur: “1. Të njohë pronësinë e ish-pronarit, të ndjerit Kahreman Vrioni, mbi një sipërfaqe toke bujqësore prej 231 ha, e ndodhur në fshatin Grize-Godolesh, Bashkia Patos, me kufizime: V - me rrugë, L - me rrugë, J - me rrugë dhe P - me tokë bujqësore. 2. Trashëgimtarët ligjorë: 1) Servete Tirana, 2) Hedije Hoxha, 3) Demir Vrioni, 4) Zija Vrioni dhe 5) Arshi Vrioni, të cilët gëzojnë në pjesë të barabarta nga 1/5, të marrin pjesë në aksione në ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos dhe Rrugë Bazamenteve Patos¹, si pronarë të tokës me vlerën e saj. Për ndërmarrjen e Ndërtim Montimit Patos 30.980 m² dhe ndërmarrjen e Rrugë Bazamenteve Patos 18.221 m²”. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë nga shoqëria “Ndërtim-Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a.

2. Me vendimin nr. 1522, datë 21.12.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur: “Pranimin e padisë së palës paditëse “Ndërtim Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a., ndaj palës së paditur, KKKP-së pranë Prefekturës së Qarkut Fier, Servete Tirana, Arshi Vrioni, Hedije Hoxha, Altin Vrioni, Zija Vrioni, Sonja Vrioni, Grabon Vrioni e Saimir Vrioni, duke kundërshtuar pikën 2 të vendimit nr.2, datë 19.12.1995 të KKKP-së pranë ish-Këshillit të Rrethit Fier. Lënien në fuqi të pikave të tjera të vendimit të mësipërm të KKKP-së”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 10.5.2002.

3. Në datën 7.1.2008, pala e paditur në procesin civil, Altin Vrioni, Saimir Vrioni, Grabon Vrioni, Servete Tirana (Vrioni), Hedije Hoxha (Vrioni), Zija Vrioni e Arshi Vrioni, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, me kërkesë për rishikimin e vendimit civil nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Me vendimin nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 1522, datë 21.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”

5. **Kërkesit, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a. dhe “Rubin Petrol Patos” sh.a.**, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe paraqesin këto argumente në mbrojtje të pretendimit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor:

5.1 Kërkesit nuk kanë pasur dijeni për procesin e rishikimit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, por janë vënë në dijeni rastësisht. Edhe pse Gjykata e Lartë prish vendime gjyqësore të 11 viteve më parë, ajo nuk thërret ligjërisht palët në gjykim, por mjaftohet vetëm me një shpallje, ndërkohë që për personat juridikë duhet të bënte shpallje në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

5.2 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Në kuptim të nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pala e paditur duhej t’i provonte Gjykatës së Lartë se, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, s’ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor. Ky është standardi që duhej të respektohej, në mënyrë që pas 11 vitesh të mos cenohen të drejtat e fituara ligjërisht, dhe gjykata s’duhej të mjaftohej vetëm me pohimin se pala nuk ishte në dijeni të procesit gjyqësor.

5.3 Parimi i sigurisë juridike është cenuar edhe për arsye se nuk është respektuar neni 494 i KPC-së, që jep kuptimin e provës së re.

6. **Subjekti i interesuar, Saimir Vrioni**, parashtrroi para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur:

6.1 Kërkesa për rishikim është depozituar në Gjykatën e Lartë brenda afatit 30-ditor, të parashikuar nga neni 496 i KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, konstatoi se provat me

¹ Në procesin gjyqësor me emrin tregtar “Rubin Petrol Patos” sh.a.

shkresë, të paraqitura, janë të reja, pasi nuk janë administruar gjatë gjykimit të themelit, dhe kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

6.2 Në vendimin objekt rishikimi, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur vendimin e saj edhe në një akt ekspertimi të kryer mbi bazën e provave të paraqitura nga pala paditëse në gjykim, duke qenë se gjykimi është zhvilluar në mungesë të subjekteve të interesuara.

6.3 Subjektet e interesuara kanë marrë dijeni me vonesë për vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe me marrjen dijeni ata i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, duke i kërkuar të dhëna suplementare për pronësinë e trashëgimlënësit të tyre. Këto dokumente të reja nuk janë përdorur në gjykim, pasi nuk diheshin prej tyre.

6.4 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e një gjykimi profesional, të paanshëm dhe objektiv, konstatoi se kërkesa e paraqitur për rishikimin e vendimit të formës së prerë ishte e bazuar dhe vendosi pranimin e saj.

II

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese

7. Bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuar shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuar duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se në rastet kur kundërshtohet procesi i rishikimit i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për vetë specifikën e këtij lloj gjykimi, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuar nuk ka mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim dhe ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 6, datë 16.2.2007; nr. 38, datë 5.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa më sipër, edhe në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuar i kanë shteruar mjetet ligjore, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me pretendimin për mosnjoftimin e kërkuar, nga ana e Gjykatës së Lartë, për procesin e rishikimit

10. Kërkuar pretendon se ata nuk janë njoftuar rregullisht për procesin e rishikimit nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka zbatuar dispozitat procedurale që rregullojnë njoftimin e palëve në gjykim, por është mjaftuar vetëm me një shpallje pranë ambienteve të saj.

11. Gjykata, në jurisprudencën e saj konstante, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë, që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 34, datë 3.10.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



12. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 12.6.2003; nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 19, datë 12.6.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në nenin 442 të KPC-së, mjetet e ankimit janë: ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjete ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit, e cila ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve por edhe me vlerësim të tyre, atëherë ky vlerësim duhet të bëhet nga Gjykata e Lartë pasi të ketë zbatuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Ky moment ka rëndësi sepse nuk mund të prishen vendime gjyqësore të formës së prerë duke prekur standardet e procesit të rregullt ligjor. Kërkesa për rishikim është një mjet ankimi dhe duhet t'i njoftohet palës tjetër sipas rregullave të përgjithshme, aq më tepër që ky mjet përbën në vetvete një kërkesë të re, për të cilën pala e interesuar jo vetëm që nuk ka dijeni, por është akoma nën përfytyrimin e realizimit konkret të së drejtës së fituar (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Bazuar në nenin 497 të KPC-së, kërkesa për rishikim paraqitet përpara Gjykatës së Lartë dhe, për shkak të karakteristikave të këtij lloji gjykimi, në këtë rast gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme për njoftimet e palëve dhe nuk procedohet me njoftimin me shpallje, si në rastin e shqyrtimit të rekurseve në seancë gjyqësore. Në këtë kuptim, për njoftimin e personave juridikë gjen zbatim neni 141 i KPC-së, i cili parashikon se: "*Njoftimet për institucionet, ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes zyrës së titullarit dhe personave të ngarkuar për të pranuar akte. Njoftimi për personat juridikë joshetërorë bëhet në qendrën e tyre, nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë njoftimin dhe në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik.*" Në rast se njoftimi për personat juridikë sipas nenit 141 nuk është i mundur, neni 141/a i KPC-së parashikon se ky njoftim bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së regjistruar në QKR.

16. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se për njoftimin e kërkuesve është proceduar vetëm me shpallje pranë Gjykatës së Lartë dhe palët nuk janë njoftuar rregullisht sipas dispozitave të 3020

lartpërmendura të KPC-së për njoftimet. Këto parregullsi kanë sjellë si pasojë mosmarrjen dijani të kërkuarit “Rubin Petrol Patos” sh.a., për zhvillimin e këtij procesi gjyqësor, ndërkohë që kërkuari tjetër, shoqëria “Ndërtim Montim Patos” sh.a., edhe pse nuk është njoftuar rregullisht, rezultoi të ketë marrë dijani për procesin dhe ka qenë i pranishëm në të. Në seancën gjyqësore të datës 10.5.2012, para Gjykatës së Lartë është paraqitur vetëm përfaqësuesi i shoqërisë “Ndërtim Montim Patos” sh.a., i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e gjykimit, në mënyrë që të njëjti me materialet e dosjes gjyqësore. Në seancën e datës 31.5.2012, Kolegji Civil, pasi ka verifikuar paraqitjen e palëve, ka deklaruar se *“u thirr dhe nuk u paraqit pala ndërgjyqëse “Rubin Petrol Patos” sh.a., ka dijani rregullisht me njoftimin e shpalljes së datës 15.5.2012 dhe shkak për mosparaqitje nuk ka”*. Kolegji Civil, edhe pse nuk kishte garancitë që ky subjekt kishte marrë dijani efektivisht për procesin dhe kishte zgjedhur vetë të mos paraqitej në seancat gjyqësore, ka vijuar me gjykimin e çështjes ndërkohë që, në aspektin e garantimit të procesit të rregullt gjyqësor, ishte detyrë e Gjykatës së Lartë të merrte të gjitha masat për njoftimin e rregullt të subjekteve që, potencialisht, mund të preken nga ky proces, në mënyrë që të ishin të pranishme në seancë gjyqësore dhe debati gjyqësor të zhvillohej në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

17. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuarit shoqëria “Rubin Petrol Patos” sh.a., për cenimin e parimit të barazisë së armëve në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, është i bazuar.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

18. Kërkuarit pretendojnë cenimin e parimit të sigurisë juridike për arsye se, sipas tyre, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar dispozitat e nenit 445 të KPC-së, që parashikon prekluzivitetin e ankimit.

19. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj², të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ky pretendim i kërkuarve refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe neni 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-1815 (292), datë 31.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha.

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha.

² Gjyqtari F. Hoxha votoi për pranimin e kërkesës vetëm për mosnjoftimin e rregullt të palëve nga Gjykata e Lartë.



VENDIM
Nr. 19, datë 25.4.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Admir Thanza	anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 22.01.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.48 Akti, që i përket:

KËRKUES: Përparim Braçe

SUBJEKT I INTERESUAR: Luan Leka

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 10 095, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimit nr. 760, datë 6.4.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 00-2012-513, datë 8.3.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

2. Pezullimi i vendimit deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 18, 33/1, 41/1, 42, 131/ç dhe f, 135/1 dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 dhe 6 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut; nenet 27, 45, 54 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; nenet 2, 6, 16, 28, 184 dhe 185 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet e kërkesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe prapësimet e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 6.6.1995, kërkesi, Përparim Braçe, dhe subjekti i interesuar, Luan Leka, kanë nënshkruar një aktmarrëveshje me objekt themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për ndërtimin, përshtatjen dhe shfrytëzimin e një hoteli, në katet 6 dhe 7, prej 300 m² secili kat, dhe 140 m² sipërfaqe në katin përdhe, të pallatit 7+1 në proces ndërtimi, të ndodhur në rrugën “M. Gjollështa”, Tiranë. Palët, po ashtu, kanë përcaktuar, ndërmjet të tjerash, kontributet e veçanta dhe të përbashkëta, në para dhe në natyrë, të secilit prej tyre si dhe subjektet të cilave do t’u përkasë pronësia e objektit pas përfundimit të plotë të tij.

2. Në datën 4.4.2008, subjekti i interesuar Luan Leka i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e kërkesit, palë e paditur në atë gjykim, të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktmarrëveshja e datës 6.6.1995, kreu V, pika 5/1, bazuar në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në nenet 153, 420, 423 të Kodit Civil (KC).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. 10 095, datë 3.12.2009, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë, detyrimin e kërkuarit të përmbushë detyrimet e rrjedhura nga aktmarrëveshja nr. 2515 Rep., nr. 979 Kol., datë 6.6.1995, duke e detyruar atë të njohë subjektin e interesuar Luan Leka pronar të dy kateve të fundit të godinës 7-katëshe dhe të katit nëntokësor të ndodhur në rrugën “M. Gjollësia”, Tiranë, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 365, datë 16.1.1997, me sipërfaqe 300 m² secili kat dhe 97,7 m² të katit përdhe të kësaj godine, si dhe kryerjen e ndryshimeve përkatëse në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë, të kësaj pasurie.

4. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 760, datë 6.4.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10 095, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-513, datë 8.3.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

6. Kërkuari, nëpërmjet kërkesës fillestare, si dhe me kërkesat e tjera shtesë, komentet dhe kundërshtimet e depozituara në vijim, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë; ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për këto arsye:

6.1. Është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi gjykimi nuk është zhvilluar nga gjykata kompetente e caktuar sipas dispozitave përkatëse të KPC-së, si në bazë të objektit të padsisë (nenet 334 e vijues të KPC-së), ashtu edhe në bazë të vlerës së padsisë (nenet 35 dhe 65 të KPC-së);

6.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e disponimit të kërkesëpadsisë, pasi ka kapërcyer kufijtë proceduralë të gjykimit duke dalë jashtë asaj që ishte kërkuar dhe duke disponuar për një padi të re të krijuar nga vetë gjykata. Në këtë drejtim, gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatës së shkallës së parë, në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

6.3. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë kryer shkelje të rënda procedurale, pasi nuk kanë respektuar dhe kanë ndryshuar objektin dhe përmbajtjen e klauzolave të aktmarrëveshjes. Po ashtu, gjykatat kanë shkelur nenet 6 dhe 28 të KPC-së, duke mos arsyetuar për kërkesën e parashkrimit të padsisë.

6.4. Është cenuar e drejta e mbrojtjes, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar rregullat procedurale për njoftimin, në drejtimet e mëposhtme:

- thirrjen e kërkuarit në gjykim në cilësinë e administratorit të shoqërisë, pasi fletëthirrjet i janë drejtuar atij si pronar i objektit;
- njoftimin e kërkesëpadsisë së re të krijuar nga gjykata;
- njoftimin për caktimin e ekspertëve dhe të detyrave të ekspertimit.

6.5. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk kanë respektuar parimin e gjësë së gjykuar, sepse në vendimet e tyre nuk kanë mbajtur parasysh përcaktimet e vendimeve të mëparshme ndërmjet palëve ndërgjyqëse, të cilat këto mosmarrëveshje i kanë cilësuar si mosmarrëveshje tregtare.

6.6. Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit, i sanksionuar nga neni 142/1 i Kushtetutës, pasi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit kanë kundërshtuar brenda pjesës arsyetuese të tyre, si dhe midis arsyetimit dhe disponimit në vendim. Këto vendime nuk kanë arsyetuar mbi kreun III, pika 3/1, “a”, “b” dhe “c” të aktmarrëveshjes së datës 6.6.1995. Po ashtu, vendimet gjyqësore të lartpërmendura janë bazuar në vendimin nr. 18 akti, datë 21.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që nuk ekziston dhe që është ekzekutuar në ZRPP me



falsifikim.

6.7. Vendimi nr. 18 akti, datë 21.10.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sigurimin e padisë, nëpërmjet të cilit është bërë nga subjekti i interesuar inskriptimi nr. 765, datë 25.10.1999, dhe heqja e barrës mbi pasurinë e paluajtshme në fjalë, në ZRPP, është antikushtetues. Për pasojë, edhe këto regjistrime janë antikushtetuese.

6.8. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar të drejtën për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanshme dhe atë të barazisë së armëve, për shkak se kanë analizuar vetëm prova të shkëputura të njërës palë dhe nuk kanë marrë parasysh kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit/gjyqtarëve të kërkuarit.

6.9. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi kanë gabuar në mënyrën e marrjes, administrimit të provave në gjykim dhe paraqitjes së tyre në vendim.

6.10. Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse nga kërkuarja janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe (shkelje procedurale) të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Në këtë mënyrë është cenuar edhe e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë.

7. Kërkuarja ka ngritur pretendime edhe mbi pezullimin e ekzekutimit të vendimit të shkallës së parë, të lënë në fuqi nga gjykata e apelit, duke parashtruar se:

7.1. vendimi cenon të drejtat e pronësisë së ortakut Përparim Braçe mbi sipërfaqen prej 697,7 m², që përbëjnë “Kontributet e veçanta” në natyrë të tij;

7.2. vendimi cenon të drejtat e pronësisë së shoqërisë “E.A.C.” sh.p.k. për ndërtimet për objektin hotel, të kryera me “kontribute të përbashkëta” në para nga të dy ortakët;

7.3. e drejta e padisë së “detyrimit tregtar” është parashtruar;

7.4. vendimi cenon parimin e gjësë së gjykuar;

7.5. në vendim nuk janë përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme sendet objekt ekzekutimi.

7.6. janë kryer veprime të reja të paligjshme hipotekore, për të cilat kërkuarja ka marrë dijeni nga prapësimet e subjektit të interesuar.

8. **Subjekti i interesuar**, Luan Leka, në prapësimet e depozituara ka parashtruar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke paraqitur argumentet e mëposhtme:

8.1. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë qenë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pasi çështja objekt shqyrtimi është një mosmarrëveshje me karakter civil, sikurse kanë arsyetuar edhe gjykatat. Ndërsa fakti që çështja është gjykuar me një gjyqtare, është pranuar nga vetë kërkuarja gjatë gjykimit. Po në këtë drejtim, nuk qëndron edhe pretendimi i kërkuarjes për vendosjen nga Gjykata Kushtetuese të seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si organ që ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete, sepse kjo Gjykatë vendos vetëm për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore.

8.2. Gjykatat nuk kanë shkelur parimin e disponimit të kërkesëpadisë dhe nuk kanë kapërcyer kufijtë proceduralë të gjykimit. Ato kanë gjykuar sipas objektit të padisë, përmbushjen e detyrimeve të aktmarrëveshjes së nënshkruar nga palët, e cila është e qartë. Po ashtu, gjykatat nuk kanë ndryshuar objektin dhe as përmbajtjen e klauzolave të aktmarrëveshjes.

8.3. Nuk është cenuar e drejta e mbrojtjes e kërkuarit, sepse ai ka marrë pjesë në disa seanca, ka paraqitur prova shkresore, ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve në të gjitha fazat e shqyrtimit të çështjes. Po ashtu, në dosje ndodhen të gjitha njoftimet për zhvillimin e seancave gjyqësore dhe kërkuarja, pa shkaqe të arsyeshme, ka zgjedhur të mos paraqitet në gjykim. Në këtë mënyrë, gjykatat kanë zhvilluar gjykimin në mungesë të tij.

8.4. Gjykatat nuk kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, sepse nuk jemi në kushtet e nenit 451 të KPC-së, pasi vendimet e mëparshme gjyqësore ndërmjet palëve janë të ndryshme nga vendimi në shqyrtim, nga objekti ose shkaku, ose nga të dyja këto elemente së bashku.

8.5. Vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, janë arsyetuar në mënyrë të plotë nga gjykatat e juridiksionit zakonshëm. Ndërsa, për gjykimin në Gjykatën e Lartë, shkaqet e paraqitura nga kërkuesi ngrenë probleme që nuk kanë të bëjnë me natyrën e shqyrtimit të çështjes në atë gjykatë. Për këtë arsye, me të drejtë, Kolegji Civil, në dhomën e këshillimit, nuk ka shqyrtuar çështjen duke vendosur mospranimin e rekursit.

8.6. Nuk është cenuar e drejta për një gjykim të drejtë nga një gjykatë e paanshme, sepse pretendimet se gjyqtarët e gjykatës së apelit nuk mund të merrnin pjesë në gjykim, janë paraqitur gjatë gjykimit dhe kërkesa nuk është pranuar nga gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (të lënë në fuqi nga gjykata e apelit)

9. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (të lënë në fuqi nga gjykata e apelit).

10. Neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Përgjithësisht, vlerësimi i Gjykatës për të vendosur pezullimin ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë *medio tempore*, para se Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës.

11. Në mbështetje të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se nuk ekziston rreziku që vendimet objekt kundërshtimi, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të mundshëm të pranimit të kësaj kërkesë nga Gjykata Kushtetuese, të prodhojnë pasoja të pariparueshme që prekin interesat e kërkuesit, pasi ky i fundit ka në dispozicion edhe mjete të tjera të parashikuara nga KPC-ja (shih *Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve*, nenet 609 e vijues të KPC-së) për mbrojtjen e të drejtave të tij. Prandaj, Gjykata çmoi si të pabazuara argumentet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e të drejtës së pronësisë së tij nga ekzekutimi i vendimeve të lartpërmendura dhe, për rrjedhojë, vendosi rrëzimin e kërkesës.

B. Lidhur me themelin e kërkesës

12. Në analizën e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata, paraprakisht, konstaton se pretendimet e kërkuesit, të paraqitura në gjithë kërkesat, komentet dhe kundërshtimet e depozituara, janë të shumta dhe në to përfshihen si çështje të gjykimit në thelb, ashtu dhe të natyrës kushtetuese. Gjykata gjen me vend të ritheksojë se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

13. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (shih *vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).



14. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ajo nuk mund të investohet për shqyrtimin e disa prej pretendimeve të kërkuarit, të cilat do të shqyrtohen në mënyrë analitike më poshtë, dhe që kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit të fakteve dhe provave, si dhe me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një “gjykatë e caktuar me ligj”

15. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një “gjykatë e caktuar me ligj” kërkuari parashtron se:

a) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka respektuar nenet 334 e vijues të KPC-së, mbi kompetencën lëndore të gjykatës, në gjykimin e mosmarrëveshjes *de quo*. Sipas kërkuarit, vendimet e mëparshme gjyqësore, nr. 586 akti, datë 17.5.2000 dhe nr. 4043, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (ky i fundit i ndryshuar me vendimin nr. 850, datë 12.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë), të cilat kanë shqyrtuar mosmarrëveshje të tjera ndërmjet të njëjtave palë ndërgjyqëse dhe që kanë të bëjnë me aktmarrëveshjen e datës 6.6.1995, i kanë konsideruar ato si çështje me natyrë tregtare. Si pasojë, edhe çështja objekt shqyrtimi, në bazë të objektit të padisë, duhet të trajtohet si mosmarrëveshje tregtare.

b) Po ashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka respektuar nenet 35 dhe 65 të KPC-së, lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Ajo ka zhvilluar gjykimin me një gjyqtare të vetme dhe jo me tre gjyqtarë sipas vlerës së padisë. Edhe gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatës së shkallës së parë në plotësimin e këtij standardi.

16. Gjykata vëren se edhe pretendimi i kërkuarit se çështja objekt shqyrtimi duhej të gjykohej nga seksioni tregtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo të trajtohej si konflikt juridiko-civil, ka të bëjë në thelb me cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Kjo për faktin se, në zbatim të parimit *iura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura nga kërkuari bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuari (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 16, datë 27.3.2012; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se subjekti i interesuar, Luan Leka, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e kërkuarit të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktmarrëveshja e datës 6.6.1995, kreu V, pika 5/1, të cilën e ka bazuar në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në nenet 153, 420, 423 të KC-së. Pavarësisht kërkesave të kërkuarit mbi natyrën tregtare të mosmarrëveshjes, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, në vendimet e tyre kanë arsyetuar se në rastin objekt shqyrtimi gjyqësor duhet të zbatohen dispozitat e Kodit Civil, që kanë të bëjnë me një kontratë të nënshkruar nga palët.

19. Gjykata vëren, gjithashtu, se vendimi nr. 586 akti, datë 17.5.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka shpallur moskompetencën e seksionit civil për shqyrtimin e çështjes, nuk ka objekt të ngjashëm me çështjen në shqyrtim, ndërsa në vendimin nr. 4043 akti, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ndryshuar me vendimin nr. 850, datë 12.7.2001 të

Gjykatës së Apelit Tiranë, gjykatat nuk kanë shpallur moskompetencën e tyre në shqyrtimin e çështjes dhe kanë bazuar vendimet e tyre në dispozitat e KC-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit nuk është i bazuar.

20. Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka çmuar se ajo (vlera e padisë) përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar mbi gjykatën kompetente. Në këtë drejtim, mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në çastin e paraqitjes së padisë, i këtij rregulli procedural që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi, mund të sjellë cenimin e elementit thelbësor kushtetues, që lidhet me gjykatën kompetente (*shih vendimet nr. 35, datë 12.12.2003 dhe nr. 13, datë 18.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga të dhënat e vendimeve objekt shqyrtimi, si dhe nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë, vlera e saj ka qenë më e madhe se 10 milionë lekë. Ndërkohë, kërkesëpadia është depozituar në datën 4.4.2008 dhe gjykimi, sipas dispozitave ekzistuese në atë kohë, me të drejtë është nisur me trup gjykues prej tre gjyqtarësh. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10 052, datë 29.12.2008, neni 35/2/a i KPC-së ka përcaktuar shumën prej 20 milionë lekësh, si vlerë të padisë, që gjykata e shkallës së parë të gjykojë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore. Bazuar në këtë parashikim të ri, procesi objekt shqyrtimi, meqë ka qenë me vlerë më të vogël se 20 milionë, ka përfunduar me një gjyqtar të vetëm.

22. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, pavarësisht karakterit civil apo penal të procesit, është shprehur, se *në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe*, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale transitorie (*shih vendimet nr. 11, datë 19.9.1995; nr. 106, datë 27.5.2002; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këtë standard kushtetues si dhe në faktin se në ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008, nuk parashikoheshin dispozita transitorie për çështjet që ishin duke u gjykuar nga gjykatat përpara këtij ligji, Gjykata arrin në përfundimin se kompetenca për shqyrtimin e çështjes i përket një gjyqtari të vetëm. Prandaj, pretendimi i kërkuarit, edhe në këtë drejtim, nuk është i bazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të disponimit të kërkesëpadisë

23. Kërkuari parashtron se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e disponimit të kërkesëpadisë, pasi ka kapërcyer kufijtë proceduralë të gjykimit, duke dalë jashtë asaj që ishte kërkuar dhe duke disponuar për një padi të re të krijuar nga vetë gjykata, dhe gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatës së shkallës së parë në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

24. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet në të gjitha shkallët e gjykimit, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por e rëndësishme është se jo çdo shkelje e ligjit mund të cenojë procesin e rregullt ligjor në aspektin kushtetues. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj, pasi detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 7, datë 28.2.2000; nr. 25, datë 28.10.2005; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se edhe pse nga materialet e dosjes gjyqësore konstatohen disa shkelje procedurale në përcaktimin e cilësisë së vërtetë të palëve si “ortak” dhe “administrator”, apo në përcaktimin ekzakt të objektit të padisë dhe bazës ligjore, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar në vendimet e tyre mbi objektin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve. Po ashtu, Gjykata konstaton se në bazë të nenit 16 të KPC-së, gjykata bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Për rrjedhojë, përderisa kërkuari nuk ka përcaktuar se



cilat standarde kushtetuese i janë cenuar si rezultat i shkeljeve të lartpërmendura, Gjykata vlerëson se ky pretendim i tij nuk është i bazuar.

26. Kërkuesi pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë dalë jashtë objektit të aktmarrëveshjes, duke e konsideruar atë si një kontratë sipërmarrjeje, i cili është një veprim juridik i paqenë. Sipas kërkuetit, gjendemi në kushtet e padisë së “detyrimit tregtar” dhe se gjykatat kanë shkelur nenet 6 dhe 28 të KPC-së, duke mos arsyetuar për kërkesën e parashkrimit të padisë.

27. Nisur nga sa u theksua në premisën e analizës së pretendimeve të kërkuetit (shih paragrafët 12-14 të këtij vendimi), Gjykata vlerëson se ky pretendim i tij nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

B.3. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes

28. Sipas kërkuetit, është cenuar e drejta e mbrojtjes në drejtimet e mëposhtme:

a) Është gjykuar pa u dëgjuar dhe thirrur në gjykim në të njëjtën cilësi si është paditur, sepse në kërkesëpadi ka cilësinë e *administratorit* të shoqërisë “E.A.C.” sh.p.k., ndërsa në fletëthirrje është thirrur si shtetas pronar;

b) Nuk i është njoftuar padia me përmbajtje të re, e krijuar nga gjykata e shkallës së parë;

c) Nuk i është njoftuar caktimi i ekspertëve dhe detyrat që u janë ngarkuar;

d) Nuk është thirrur në gjykim si palë zotëruese e *kontributeve të veçanta*, edhe pse gjykata ka disponuar mbi to;

e) Nuk është thirrur në gjykim shoqëria “EAC” sh.p.k. edhe pse gjykata ka disponuar mbi të drejtat e pronësisë së saj.

29. Nga materialet e dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se kërkuesi ka pasur dijeni për të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit dhe, për pjesën me të madhe të tyre, ka depozituar një sërë notash verbale për të shfaqur arsyet e mosparaqitjes së tij në gjykim. Nga shqyrtimi i dokumenteve shkresore të administruara në dosjen gjyqësore si fletëthirrjet, kërkesat paraprake dhe notat e shumta verbale, të paraqitura nga vetë kërkuesi gjatë procesit gjyqësor, Gjykata arrin në përfundimin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë masat e duhura ligjore dhe, në funksion të procesit të drejtë, i kanë dhënë mundësinë kërkuetit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar në këtë mënyrë edhe parimin e barazisë së armëve. Për pasojë, pretendimi i kërkuetit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, është i pabazuar.

B.4. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

30. Kërkuesi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre, objekt kundërshtimi, nuk kanë mbajtur parasysh vendimet e mëparshme gjyqësore nr. 586 akti, datë 17.5.2000 dhe nr. 4043, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i ndryshuar me vendimin nr. 850, datë 12.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë), të cilat, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve ndërmjet të njëjtave palë ndërgjyqëse dhe që kanë të bëjnë me aktmarrëveshjen e datës 6.6.1995, i kanë konsideruar ato si çështje me natyrë tregtare. Në këtë mënyrë është cenuar parimi i gjësë së gjykuar (*res judicata*).

31. Sipas nenit 451/a të KPC-së: “*Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe*”.

32. Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi, dhe vendimet nr. 586 akti, datë 17.5.2000 dhe nr. 4043, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i ndryshuar me vendimin nr. 850, datë 12.7.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë), kanë të njëjtat palë ndërgjyqëse, por nuk kanë objekt dhe shkak të njëjtë. Si pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit, për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, është i pabazuar.

B.5. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit

33. Lidhur me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, kërkuesi ka parashtruar se këto vendime nuk janë arsyetuar në mënyrë të përshtatshme dhe logjike, kanë kundërshti brenda pjesës arsyetuese të tyre, si dhe midis arsytimit dhe disponimit në vendim. Gjithashtu, këto vendime nuk kanë arsyetuar mbi kreu III, pika 3/1, a, b dhe c të aktmarrëveshjes së datës 6.6.1995, si dhe janë bazuar në vendimin nr. 18 akti, datë 21.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që nuk ekziston dhe që është ekzekutuar në ZRPP me falsifikim. Në lidhje me këtë vendim të fundit, kërkuesi pretendon se ai është antikushtetues dhe se inskriptimi nr. 765, datë 25.10.1999, dhe heqja e barrës mbi pasurinë e paluajtshme në fjalë, në ZRPP, të kryera nga subjekti i interesuar mbi bazën e vendimit nr. 18 akti, datë 21.10.1999, janë antikushtetuese.

34. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimit gjyqësor si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Nga analiza e vendimeve objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit janë të arsyetuara dhe se ato nuk bien ndesh me kërkesat e Kushtetutës dhe të Kodit të Procedurës Civile. Gjykatat kanë analizuar dhe shqyrtuar të gjitha rrethanat e çështjes dhe provat e paraqitura nga palët, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit dhe duke parashtruar në vendim argumentet për rrëzimin e tyre, prandaj, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit, nuk është i bazuar.

B.6. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

36. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë respektuar të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke parashtruar këto shkaqe:

a) Gjykata e shkallës së parë ka analizuar në vendim vetëm prova të shkëputura të njëjës palë;

b) Gjyqtarja E.LI. e caktuar rishtas në trupin gjykues për gjykimin në shkallë të parë të çështjes objekt shqyrtimi, ka qenë e ndikuar subjektivisht dhe objektivisht nga pjesëmarrja në trupin e parë gjykues, në dhënien e dy vendimeve të datave 18.11.2008 dhe 26.12.2008, të pranimit të dorëheqjes së gjyqtarës B.M;

c) Gjyqtarët A.M. dhe Sh.M., të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, ishin përjashtuar nga gjykimi i çështjeve penale në ngarkim të kërkuesit dhe nuk mund të merrnin pjesë përsëri në gjykimin e një çështjeje me të njëjtat palë;

d) Anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ishin të njëanshëm, derisa vendosën mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit.

37. Për sa i përket pretendimit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatave, në jurisprudencën e saj Gjykata, edhe nën dritën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka analizuar dhe ka dhënë përkufizimet e nevojshme mbi nocionin “*gjykatë e paanshme*”, duke theksuar se ky parim ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e këtij parimi për shkak të mënyrës së shqyrtimit të provave, si dhe për mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e juridiksionit zakonshëm, janë të pabazuara.

38. Lidhur me pjesëmarrjen në gjykimin civil të gjyqtarëve që janë përjashtuar nga gjykimi penal, Gjykata, në jurisprudencën e saj, në një çështje të ngjashme, ka vlerësuar se “*natyra e përgjegjësisë sipas legjislacionit civil është e ndryshme nga ajo e legjislacionit penal, pasi standarde*



të ndryshme të të provuarit zbatohen në çështje civile dhe penale; se një dënim penal nuk përjashton gjetjen e një përgjegjësie civile që lind nga të njëjtat fakte dhe se në të kundërt, ekzistenca e përgjegjësisë civile nuk sjell nevojshmërisht një vendim fajësie sipas ligjit penal, në lidhje me të njëjtat veprime të të pandehurit. Një situatë në të cilën i njëjti gjyqtar shqyrton si çështjen e përgjegjësisë civile, edhe të asaj penale të lindura nga të njëjtat fakte, nuk prek domosdoshmërisht paanshmërinë e gjyqtarit”(shih vendimin nr. 33, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

39. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pjesëmarrja në apel e dy gjyqtarëve A.M. dhe Sh.M. nuk cenon parimin e paanshmërisë së gjyqtarit, edhe sepse këta gjyqtarë ishin përjashtuar nga shqyrtimi i dy çështjeve penale të mëparshme, në ngarkim të kërkuesit, pra, ata nuk ishin investuar më parë, për shkak të përjashtimit të tyre, për shqyrtimin e fakteve penale. Përveç kësaj, kërkuesi nuk paraqet në kërkesë asnjë argument për rrethana objektive dhe subjektive, të cilat do të çonin në anësinë e dy gjyqtarëve në fjalë lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

40. Gjykata, po ashtu, çmon se edhe pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtarës E.Ll. nuk është i bazuar, pasi, ndryshe nga sa ai parashtron, vendimet e datës 18.11.2008 dhe 26.12.2008, të pranimit të dorëheqjes së gjyqtarës B.M., janë të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, A.M., dhe jo të gjyqtarës që ka gjykuar çështjen, E.Ll.

B.7. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

41. Në thelb të këtij pretendimi kërkuesi parashtron se gjykatat kanë marrë, por nuk kanë administruar provën kryesore, aktmarrëveshjen e datës 6.6.1995, fakt, i cili ka passjellë krijimin nga ana e gjykatave të dy veprimeve juridike (*Kontratë të Shoqërisë së Thjeshtë* dhe *Kontratë Sipërmarrjeje*) të paqena.

42. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi dhe bazuar edhe nga sa u analizua më sipër, Gjykata çmon se aktmarrëveshja është provë e marrë dhe e administruar nga gjykatat, si një nga provat bazë të shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Ndërsa, interpretimi i saj nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk hyn në juridiksionin kushtetues (shih paragrafët 12-14 të këtij vendimi).

B.8. Për pretendimin për mospranimin e rekursit në Gjykatën e Lartë

43. Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse nga ai janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe (shkelje procedurale) të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

44. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminuar të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (shih vendimin nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

45. Në vështrim të sa më lart, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit nuk janë të bazuara.

46. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit të çështjes objekt shqyrtimi, nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “c” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri:

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 6.5.2013
Doli nga shtypi më 6.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 28 lekë